



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:226285
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05504607

C.nr.1310/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtar Blerim Istrefi dhe me praktikantin e kësaj gjykate Bardh Avdiu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses: B.U me vendbanim në adresë: rr: "H.O", nr.12, P, të cilën e përfaqëson M.K avokat nga D, kundër të paditurit: B.U me vendbanim nga fsh. V i P, M, nga baza juridike: propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, duke vendosur për deponimin e mjeteve në emër të garancionit, jashtë seancës me datë 26.03.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZHET propozimi i paditëses: B.U, nga Prishtina, me të cilin kane kërkuar që të caktohet masa e sigurisë ashtu që i **NDALOHET** të paditurit, çdo veprim lidhur me paluejtshmerine sipas njësisë kadastrale me nr. 01093..., ZK V i P, M, si dhe ti ndërpres të gjitha punimet në ndërtimin e xhamisë dhe rrënimin e objekteve që gjinden në lokacionin e larte cekur, e gjithë këtë deri në përfundimin e plotfuqishëm të këtij kontesti.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të tij me datë 24.10.2023 ka paraqitur padi në gjykatë kundër të paditurit, nga baza juridike tjetërsim i pronës dhe dëmtim i pasurisë së paluajtshme, me propozim që gjykata të lëshoi masën e sigurisë.

Gjykata ka caktuar seancën dëgjimore dhe sipas propozimit të paditëses- propozueses ka caktuar daljen në vend të ngjarjes dhe nxirjen e provës me ekspertim nga lëmi i gjeodezisë duke iu referuar dispozitës së nenit 356 të LPK-së, ku pas pranimit të ekspertizës së gjeodezisë, gjykata me qëllim që të mund të veprohet sipas propozimit të paditësit për lëshimin e masës së sigurisë, me aktvendimin e datës 26.03.2024, ka caktuar garancionin për sigurimin e dëmit eventual që mund ti shkaktohet të paditurit me rastin e caktimit dhe ekzekutimit të masës së siguroese, ku

paditësi është i detyruar që në afatin prej 7 ditësh në xhirollogarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës e përmes arkës së kësaj gjykate, të deponoj shumën e garancionit , dhe gjykatës ti prezantojë dëshmi për deponimin e bërë, në të kundërtën nëse në afatin kohor të dhënë gjykatës nuk i prezantojnë dëshmi lidhur me deponimin e garancionit, propozimi për caktimin e masës së sigurisë do të refuzohet.

Nga fletë kthesa e kthyer e cila është pjesë përbërëse e shkresave të lëndës, vërtetohet se të njëjtin aktvendim i autorizuari i të paditësit e ka pranuar me datë 14.02.2024, ku i njëjti që nga data e pranimit të aktvendimit, gjykatës nuk i prezantojë dëshmi se është deponuar shuma e garancionit të caktuar nga gjykata për lëshim të masës së sigurisë.

Prandaj, duke pasur parasysh se paditësi nuk ka bërë deponimin e garancisë së kërkuar nga gjykata brenda afatit kohor të dhënë, gjykata në mbështetje të dispozitës së nenit 297.3 të LPK-së, gjeti se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që propozimi i paditësit për lëshimin e masës së përkohshme siguroese kundër të paditurve të refuzohet me çka edhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke i'u referuar nenit 313.1 të LPK-së, po që se propozuesi i sigurimit brenda afatit të caktuar me aktvendim mbi caktimin e masës së sigurimit nuk paraqet provën e përcaktuar në nenin 314 të këtij ligji gjykata do ta përfundon procedurën dhe anulon veprimet e kryera.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.1310/2023,dt. 26.03.2024**

**GJYQTARI;
Blerim Istrefi**

UDHËZIM JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.